



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	11.11.2021
<b>Referenc-ë:</b>	08-353/01-239722/21/1
<b>Për/ Za/ To:</b>	OJQ “Artpolis”
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokoll 08-353/01-239722/21/1 nga OJQ “Artpolis” me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike sheshi “Zahir Pajaziti” dhe “Nëna Terezë” me ndalesë para Qeverisë së Republikës së Kosovës me datë 05.12.2021 nga ora 12:00 deri në ora 13:00.

Qëllimi i kërkesës është ngritja e vetëdijes për parandalim të dhunës në baza gjinore, respektivisht dhunës ndaj grave.

Artpolis do të organizojë performancë dhe aksion në rrugë të pasuar me marsh për të kërkuar drejtësi për gratë viktime të dhunës në familje dhe ato që u vranë si pasojë e saj.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin OJQ “Artpolis” për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Zahir Pajaziti” dhe “Nëna Terezë” me ndalesë para Qeverisë së Republikës së Kosovës me datë 05.12.2021 nga ora 12:00 deri në ora 13:00 për realizimin e aktivitetit sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Për të njëjtin aktivitet të lajmërohet Policia e Kosovës;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

**Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.**

18/11/2021

E. Duka

faqe 1 nga 1